



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

---

**BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE DHE PASUNIVERSITARE NË TURQI,  
VITI AKADEMIK 2015-2016**

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Turqinë në fushën e arsimit dhe shkencës, Qeveria Turke akordon bursa studimi universitare dhe pasuniversitare për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në universitetet turke, për vitin akademik 2015-2016. Konkretisht ofrohen këto programe:

Për studime universitare

1. Programi rajonal i bursave;
2. Programi “Ibni-Sina” në fushën e shëndetësisë;
3. Programi “Yunus Emre” i gjuhës turke;
4. Programi i bursave për teologji islamike;
5. Programi i bursave në fushën e artit;
6. Programi i bursave në fushën e sportit

Për studime pasuniversitare

1. Programi “Ali Kuşçu” në fushën e shkencës dhe teknologjisë;
2. Programi “Ibni-Haldun” në fushën e shkencave sociale;
3. Programi “Yunus Emre” i gjuhës turke;
4. Programi i bursave për teologji islamike;
5. Programi i bursave në fushën e artit;
6. Programi i bursave në fushën e sportit

Risia e këtij viti është se kandidatët e huaj do të aplikojnë me bursë të shtetit turk në universitetet më prestigjioze të Turqisë për programe studimi universitare/pasuniversitare në fushën e artit dhe të sportit ose në PhD (vetëm në arte).

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

1. Të jenë në përfundim të vitit shkollor ose të ketë përfunduar arsimin e mesëm;
2. Kandidatët për studime universitare të kenë lindur mbas datës 01.01.1994; Kandidatët për studime Master duhet të mos kenë kaluar moshën 30 dhe ata për studime PhD të jenë nën moshën 35 vjeç, të kenë lindur mbas datës 01.01.1980;
3. Të mos jenë duke ndjekur aktualisht ndonjë program tjetër studimi në Turqi;
4. Të mos kenë humbur të drejtën e bursës (përjashto arsyet shëndetësore dhe të fatkeqësive natyrore), në rast se më parë kanë fituar bursë shtetërore për të studiuar në Turqi;
5. Të kenë një notë mesatare mbi 9 (nëntë) në rastet kur kandidatët universitarë aplikojnë për shkencat mjekësore;
6. Të jenë të aftë nga ana shëndetësore.

Procedura e aplikimit online përfshin:

- a) Plotësimin e formularit të aplikimit, i cili gjendet në adresën e internetit: <http://www.turkiyeburslari.gov.tr>. Aplikantët, do të bëjnë fillimisht regjistrimin online. Pasi të kenë hyrë në sistem, kandidatët duhet të plotësojë formularin e aplikimit duke përcaktuar fushën e studimit;
- b) Aplikantët, gjithashtu, duhet të shkarkojnë në sistemin online dokumentet sipas listës në vijim:

Për programet e studimit universitare:

1. Vërtetimin e notave për tri vitet e shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria ose Zyra Arsimore e rrethit përkatës;
2. Fotokopjen e faqes së të dhënave të pasaportës;
3. Një fotografi dokumenti.

Për programet e studimit master/ studime të avancuara:

1. Kopjen e Diplomës që vërteton mbarimin e programit të nivelit të parë të studimeve universitare (Bachelor) ose të nivelit dytë të studimeve (Master Profesional/Master i Shkencave);
2. Listën e notave sipas niveleve të studimeve;
3. Fotokopjen e faqes së pasaportës;
4. Një fotografi dokumenti

Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të pakthyera në gjuhët turke/angleze/ ose frënge dhe të jenë të noterizuara sipas kritereve të përcaktuara nga universitetet përkatëse.

Gjuha e mësimit në universitetet turke është gjuha turke. Të gjithë aplikantët do t'i nënshtrohen vitit përgatitor të gjuhës turke për vitin 2015-2016. Në disa universitete programe të veçanta studimi mund të ndiqen edhe në gjuhën angleze, frënge ose gjermane. Kusht për fillimin e studimeve në këto gjuhë është dhënia e provimit ndërkombëtar dhe certifikimi për njohjen e gjuhës së huaj (niveli C1).

Procedurat e seleksionimit për fituesit e bursave realizohen nga universitetet turke. Bursa e studimit mbulon të gjitha shpenzimet e ushqimit, të akomodimit, si dhe të udhëtimit dhe tarifën e shkollimit. Studenteve të përzgjedhur do t'iu alokohet edhe një bursë mujore.

Afati i fundit për këtë aplikim është data **31 mars 2015**. Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, si dhe të listës së universiteteve përkatëse, referojuni adresave në web-site:

<http://www.turkiyeburslari.gov.tr> ;

[www.trscholarships.org](http://www.trscholarships.org)

## **DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE**